

RAPORT SHITESË MBI

ZGJEDHJET LOKALE 2013 NË KOSOVË



Konrad
Adenauer
Stiftung

Pas publikimit të handbook-ut mbi zgjedhjet lokale në Kosovë, fondacioni Konrad Adenauer prezanton raport mbi rezultatin e zgjedhjeve, pjesëmarrjen e votuesve, mbarëvajtjen e procesit zgjedhor si dhe për mbulueshmërinë mediatike të zgjedhjeve lokale në Kosovë.

Janar 2014

www.kas.de/kosovo

Zgjedhjet lokale në Kosovë, rezultatet finale

Granit Tërnav

Lista e Shkurtesave

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

LDK – Partia Demokratike e Kosovës

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKR- Aleanca Kosova e Re

VV – Lëvizja Vetëvendosje

GIS – Iniciativa Qytetare Serbe

SLS- Partia e Pavarur Liberale

PD- Partia e Drejtësisë

LB – Lëvizja për Bashkim

PSHDK- Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës

OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian

RTK – Radio Televizioni i Kosovës, transmetues publik

TV21- Televizion privat në Kosovë

Klan Kosova- Televizion privat në Kosovë

DW- Deutsche Welle, Transmetues ndërkombëtar Gjerman

BBC- Transmetues Britanik

KFOR – Trupat e NATO-s në Kosovë

Pas një palë zgjedhesh të kontestuara për saktësinë e tyre dhe me shumë dyshime për mashtrime, Kosova kishte një test shumë të rëndësishëm për të organizuar zgjedhje të rregullta dhe të lira. Ky është një standard i kërkuar për demokracinë dhe që do të ishte elementi kyq për vazhdimin e rrugës së integritit Europian të Kosovës.¹ Arritja e marëveshjes së prillit në Bruksel mes kryeministrit të Kosovës Hashim Thaqit dhe atij serb Ivica Dacicit kishte sjellur edhe një situatë të re dhe sfiduese për Kosovën, atë në të cilën strukturat paralele në vend të futeshin në sistemin e Kosovës dhe për herë të parë të merrnin pjesë në zgjedhjet e organizuara nga Kosova.²

Duket që presioni i madh vendor dhe ndërkombëtar për standardin e kërkuar për zgjedhjet kishte ndikimin e vet tek institucionet dhe partitë politike të cilat siguruan përmes institucioneve shtetërore dhe vullnetit politik një palë zgjedhje të cilat u përshëndetën nga të gjithë dhe të cilat ishin brenda standardeve të kërkuara ndërkombëtare³.

Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 46.31 %⁴ e që është llogaritet e kënaqshme krahasuar me pjesëmarrjen nga zgjedhjet e kaluara.

Fushata zgjedhore ishte kryesisht e qetë dhe pa shumë incidente të cilat do ti prishnin imazhin këtyre zgjedhjeve edhe pse u shënuar disa raste të presionit mbi punonjësit publik për pjesëmarrje në aktivitete parazgjedhore.⁵

¹ Ndërkombëtarët Kërkojnë Zgjedhje pa Manipulime, artikulli mund të gjendet në <http://gazetajnk.com/?cid=1,1070,6908>, shikuar së fundmi më 21.01.2014.

² Pjesëmarrja e serbëve të veriut në zgjedhje-historike për Kosovën, artikulli mund të gjendet në <http://www.kosova.info/lajme/pjesemarrja-e-serbeve-te-veriut-ne-zgjedhje-historike-per-kosoven/>, shikuar së fundmi më 21.01.2014.

³ ENEMO: Elections of international standards, artikulli mund të gjendet në <http://www.kosovapress.com/en/nacional/enemo-elections-of-international-standards-6876/>, shikuar së fundmi më 21.01.2014.

⁴ Zgjedhjet lokale në Kosovë, Statistika të përgjithshme, http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/1%20-%20MAssembly%20-%20General%20Statistics_irtsmvxufd.pdf, shikuar së fundmi më 21.01.2014.

⁵ MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE (BE MVZ) : DEKLARATË PRELIMINARE. Një hap pozitiv përpara për demokracinë në Kosovë: http://www.eueom.eu/files/pressreleases/other/preliminary-statement-in-kosovo-05112013_sq.pdf

Duke marrë parasysh kushtet e veçanta në katër komunat veriore, përgatitjet administrative për zgjedhjet komunale kanë qenë të ndryshme në tërë Kosovën. Në shumicën e komunave, përgatitjet teknike duke se kanë shkuar pa ndonjë pengesë të madhe. Megjithatë, përfshirja e popullatës serbe në veri dhe e serbëve të zhvendosur ngriti shumë çështje komplekse dhe politikisht të ndjeshme që duhej të trajtoheshin nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në kuadër të rolit të tij lehtësues. Zgjedhjet u administruan nga një administratë zgjedhore në tri nivele e cila kryesisht përbëhej nga përfaqësuesit e partive më të mëdha politike. Derisa KQZ është organ i përhershëm, 38 KKZ-të dhe rreth 2,400 KKV-të ishin emëruar vetëm për këto zgjedhje. Kryesuesja e KQZ-së ishte zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Dhjetë anëtarët e KQZ-së ishin caktuar nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare në Kuvendin e Kosovës, katër nga të cilët përfaqësonin komunitetet pakicë. Përkundër pretendimeve se KQZ është shumë e politizuar, anëtarët e KQZ-së dukej se punonin në mënyrë kolegjiale gjatë periudhës së veprimtarisë së BE MVZ-së. Përgatitjet për zgjedhje ishin të centralizuara dhe vëzhguesit raportuan se disa KKZ kishin kritikuar nivelin e mbështetjes që kishin marrë nga Sekretariati i KQZ-së. KKZ-të kishin praktika të ndryshme të punës. Disa mbanin takime të shpeshta formale ndërsa të tjerët takoheshin joformalisht dhe nuk mbanin procesverbale. Përveç atyre në komunat veriore, KKZ-të ishin funksionale dhe gëzonin besimin e palëve kryesore të interesit në këto zgjedhje.⁶

Dita e zgjedhjeve kaloi e qetë në shumicën e komunave të Kosovës përveç asaj të Mitrovicës Veriore, në të cilën kriminelë të maskuar sulmuan me forcë disa vendvotime duke detyruar zyrtarët e angazhuar në këto qendra që të largohen nga ato dhe duke lënë mbrapa materialin zgjedhor.⁷ Ky veprim kriminal u dënua nga të gjithë akterët ndërkombëtar dhe vendor ndërsa zgjedhjet në këto qe vendvotime u përsëritën në një datë tjetër para asaj të 1 dhjetorit.

Në përgjithësi, mediat u ofruan subjekteve politike mënyra të ndryshme për t'i përcjellë mesazhet e tyre te elektorati, dhe u ofruan votuesve informata të shumta për të ju mundësuar atyre të bëjnë zgjedhje të informuar. Gjatë periudhës së fushatës u respektua liria e shprehjes e cila garantohet me Kushtetutë.

Fushata kishte paraqitje mjaft të madhe në mediat nacionale, duke përfshirë edhe një numër shumë të madh të spoteve me pagesë dhe transmetimin e drejtpërdrejtë të tubimeve, mbulimin e gjerë në lajme dhe debatet e shumta që zhvilloheshin për komunat e ndryshme. Mediat visuale, ato të shkruara dhe veqanerisht gazetatat online, i kushtuan vëmendje të posaçme fushatës në Prishtinë. Megjithatë edhe komunat tjera u mbuluan rregullisht nga mediat, paraqitja në lajme në masë të madhe varej nga prania e udhëheqësve të partive, e jo nga aktivitetet e kandidatëve komunalë apo nga temat lokale. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), përgjegjës për mbikëqyrjen e mediave transmetuese gjatë fushatës, pranoi nëntë ankesa zyrtare. Fakti se Komisioni përbëhet nga të emëruar politikë ndikoi në punën e tij. Dy nga shtatë anëtarët e tij nuk ishin emëruar fare për shkak të mosmarrëveshjeve politike, dhe dy të tjerë u kritikuan se kishin marrë pjesë në fushatën zgjedhore.⁸

Shumica e mediave të monitoruara i kishin mbuluar më së shumti subjektet më aktive politike. PDK ishte mbuluar më së shumti në shumicën e mediave në gjuhën shqipe. Në emisionet e veta të lajmeve. Televizioni Publik RTK 1 demonstroi një preferencë të dukshme në paraqitjen e PDK-së, posaçërisht udhëheqësit të saj, Kryeministrit Z. Hashim Thaçi.⁹ Televizioni privat TV21 u ofroi shikuesve të vet një portretizim të balancuar të garuesve, ndërsa në disa media të tjera, si në televizionin nacional KTV dhe në gazetën Koha Ditore, mbulimi i PDK-së ishte me ton më kritik. Të dy kanalet transmetuan edhe programe dhe debate analitike shumë cilësore. Ndërsa Klan Kosova ishte e pranishme në shumicën e komunave duke raportuar drejtpërdrejtë ashtu edhe si televizionet tjera

⁶ Ibid.

⁷ Sulmohet një qendër e votimit në veri, 40 ndërkombëtarë ikin, artikulli mund të gjendet në <http://koha.net/?page=1,13,164338> , shikuar së fundmi më 21.01.2014.

⁸ MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE (BE MVZ) : DEKLARATË PRELIMINARE. Një hap pozitiv përpara për demokracinë në Kosovë: http://www.eueom.eu/files/pressreleases/other/preliminary-statement-in-kosovo-05112013_sq.pdf .

⁹ Ibid.

pra RTK, RTV21 dhe KTV. Por në momentin e rezultateve preliminare që fillimisht shpalljen e bëri Demokracia në Veprim, Klan Kosova nuk e përcillte përditësimin për komunën e Gjakovës. Për të cilin veprim kryetarja e zgjesdhur në Gjakovë, në emisionin e udhëhequr nga kryesuesi i këtij televizioni u kritikua për mos shpërndajrn e lajmit në kohë nga televizioni në fjalë. Ndërsa në dy kanalet televizive private në gjuhën serbe të cilat u monitoruan, TV Most shfaqti një anim në favor të Iniciativës Qytetare Serbe. Kanali televiziv publik në gjuhën serbe RTK 2 pati një mbulim të balancuar, përfshirë edhe në debate, të garuesve që përfaqësonin votuesit serbë, malazezë dhe boshnjakë.¹⁰

Procesin zgjedhor përveq që përcollën mediat lokale e kanë përcjell dhe ato ndërkombëtare si BBC dhe DË, që të dyja këto portale të lajmeve janë përqendruar në incidentin i cili ndodhi në Mitrovicën e Veriut ku portal i lajmeve DË-ës theksonte se Ulrike Lunacek raportoi para parlamentit Evropian se zgjedhjet lokale shkuna më mirë se ato të vitit 2010, dhe ishin demokratike në tërë vendin përjashtuar vetëm Mitrovicën e Veriut.¹¹ Pas raundit të dytë të zgjedhjeve pasi që shumë komuna shkuan në balotazh përfshirë këtu edhe Mitrovica e Veriut përsëri focus i mediave ndërkombëtare dhe atyre lokale komunat me shumicë serbe DË në një komunikatë të lëshuar theksonte se policia e Kosovës është në gjendje gatishmërie së bashku me policët ndërkombëtar të NATO-s dhe KFOR-it dhe sipas Roberto Gualtieri kryesusi i misionit të BE-se mbikqyrjes së zgjedhjeve e quajti dhunën në komunat serbe si krim ndaj të drejtave të njeriut.¹²

Fondacioni Konrad Adenauer, zyra në Prishtinë ka përcjellur në masë të madhe tërë procesin elektorale në Kosovë, përfshirë dhe ditën e zgjedhjeve. Ne poashtu i vlerësojmë këto zgjedhje si të drejta, fer dhe demokratike me disa vërejtje të vogla por që nuk kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në rezultatin e zgjedhjeve. Ky raport është shtesë i handbook-ut të përgaditur më parë për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Më poshtë gjeni rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë komunash dhe kuvende komunale të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (<http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-komunale-2013>)

¹⁰ Ibid.

¹¹ One more try for Kosovo elections, artikulli mund të gjendet nw : <http://www.dw.de/one-more-try-for-kosovo-elections/a-17231027>, shikuar së fundmi më 21.01.2014.

¹² Ibid.

KOMUNA	KRYETAR I ZGJEDHUR	PARTIA POLITIKE
Deçan	Rasim Selmanaj	AAK
Gjakovë	Mimoza Kusari-Lila	AKR
Glllogovc	Nexhat Demaku	PDK
Gjilan	Lutfi Haziri	LDK
Dragash	Salim Januzi	PDK
Istog	Haki Rugova	LDK
Kaçanik	Besim Ilazi	PDK
Klinë	Sokol Bashota	PDK
Fushë-Kosovë	Burim Berisha	LDK
Kamenicë	Begzad Sinani	PDK
Mitrovicë e Jugut	Agim Bahtiri	AKR
Leposaviç	Dragan Jablanovic	G.I. SRBSKA
Lipjan	Imri Ahmeti	LDK
Novobërdë	Svetislav Ivanovic	G.I. SRBSKA
Obiliq	Xhafer Gashi	AAK
Rahovec	Idriz Vehapi	PDK
Pejë	Gazmend Muhaxheri	LDK
Podujevë	Agim Veliu	LDK
Prishtinë	Shpend Ahmeti	Lëvizja Vetëvendosje
Prizren	Ramadan Muja	PDK
Skenderaj	Sami Lushtaku	PDK
Shtime	Naim Ismajli	PDK

Shtërpçë	Bratislav Nikolic	SLS
Suharekë	Sali Asllanaj	LDK
Ferizaj	Muharrem Svarqa	LDK
Viti	Sokol Haliti	LDK
Vushtrri	Bajram Mulaku	PDK
Zubin Potok	Stevan Vulovic	G.I. SRBSKA
Zvečan	Vucina Jankovic	G.I. SRBSKA
Malishevë	Ragip Begaj	IQM
Junik	Agron Kuçi	AAK
Mamushe	Arif Butuç	KTAP
Hani i Elezit	Rufki Suma	Kandidat i pavarur
Gracanica	Branimir Stojanovic	G.I. SRBSKA
Ranilluk	Gradimir Mikic	G.I. SRBSKA
Partesh	Nenad Cvetkovic	G.I. SRBSKA
Klllokot	Srecko Spasic	G.I. SRBSKA
Mitrovica e Veriut	Goran Rakic □	G.I. SRBSKA

KOMUNA	Numri i asambleistëve ne komunë	PDK	LDK	AAK	VV	AKR	GIS	SLS	Të tjera
Deçan	27	3	9	13	2				
Gjakovë	35	6	4	9	2	9			5
Glllogovc	31	20	1	1	1	1			7
Gjilan	35	8	11	4	4	2			6
Dragash	27	8	7	2		1			9

Istog	27	12	4	6	1	1	1		2
Kaçanik	27	11	4	5	3	1			3
Klinë	27	9	5	5	1	1	1		5
Fushë-Kosovë	27	6	12	1	3	1	1		3
Kamenicë	27	7	8	4	1	4			3
Mitrovicë e Jugut	35	14	8	2	3	5			3
Leposaviç	19						8	2	9
Lipjan	31	10	9	5	2		1		4
Novobërdë	15	1	4				3	1	6
Obiliq	21	4	5	4	1		1		6
Rahovec	31	11	7	8	2	1			2
Pejë	35	6	10	10	2	1	1		5
Podujevë	35	12	15	3	3	1			1
Prishtinë	51	8	18	4	10	4	1		6
Prizren	41	10	9	3	3	1			15
Skenderaj	31	26	1	1	1	1			1
Shtime	21	10	5	2	2				2
Shtërpcë	15	2	1		1		6	5	
Suharekë	31	8	10	10		2			1
Ferizaj	41	14	13	5	4	2			3
Viti	27	6	9	5	5	1			1
Vushtrri	35	12	7	6	3	2	1		2
Zubin Potok	15	1	2				11		1
Zvečan	15	1	1				8		5

Malishevë	31	8	8	1	2	1			11
Junik	15	2	5	6	2				14
Mamushe		1							
Hani i Elezit	15	5	3	4	3				
Gracanica	19						9	3	7
Ranilluk	15						6	3	6
Partesh	15						3	6	6
Klllokot	15	2	1	1			4	5	2
Mitrovica e Veriut	19	3	1	1			6	1	7

Partia	Numri i kryetarëve të zgjedhur nga 38 komuna në total	Numri i Asambleistëve
PDK	10	267
LDK	9	217
AAK	3	131
VV	1	67
AKR	2	43
GIS	9	72
SLS	1	26
Partitë tjera politike, kandidatët e pavarur, entitetet politike, (PD, LB, PSHDK), total:	3	169

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung
Zyra në Kosovë
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6
KO-10000 Pristina
Telefon +381 (0) 38 229 874
Prishtina@kas.de
www.kas.de/kosovo

Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë
pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin
domosdoshmërisht qëndrimet e
Fondacionit Konrad Adenauer.